



Pranimar / Dorezuar Primijsen / Predato Received / Delivery		11.06.2021	viti god year
Organ / Njësia Organi / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBARK	3027/2021		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.488/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.301/20 të datës 31.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.759/2019 të datës 11.12.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr.“Xhemajl Mustafa”, SU9/1, Llamella 4, Nr.47, në Dardani/Prishtinë, kundër organit të punësimit/Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 11.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.759/2019 e datës 11.12.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 11.12.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5781/2019 të regjistruar me numër A.nr.759/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, me datë 23.12.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në

Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli, me datë 09.01.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuoromit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 31.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.301/20 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 11.12.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5781/2019 të regjistruar me numër A.nr.759/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Urdhër obligimin për pagesë të datës 06.12.2019; Kërkesën e datës 19.11.2019; Aktgjykimin AA.nr.84/2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.1599/2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Urdhër obligimin për Pagesë të datës 28.10.2019; Kërkesën e datës 29.10.2019; Aktgjykimin A.nr.1760/2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Kërkesën e datës 16.10.2019; Aktgjykimin AA.nr.181/2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.193/16 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Akt Emërimit e datës 30.11.2018 të ankuesit; Lajmërimin për përfundimin e shërbimit, të datës 14.01.2019 për ankuesin; Kërkesën për paga jubilarë nga ankuesi, të datës 30.10.2019; Vendimin me Nr.Prot 324/A të datës 11.06.2019 nga Drejtorit i Përgjithshëm i ATK-së; Përgjigjen në kërkesë, të datës 22.11.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë, të datës 23.12.2019; Njoftimin e datës 20.01.2020 për ankuesin dhe Aktgjykimin A.nr.301/20 të datës 25.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, ***është e pa bazuar, sepse:***

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 30.11.2018 është konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në pozitën e punës Inspektor Tatimor pranë Administratës Tatimore të Kosovës. I njëjti me datë 14.01.2019 është njoftuar nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës, së me datë 07.06.2019 i përfundon marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 11.06.2019 ka nxjerr Vendimin me Nr. Port:324/A përmes të cilit ankuesit i është njohur e drejta për realizimin e një pagë të njëhershme në vlerën 484.64 euro në emër të pensionimit.

Ankuesi më datë 30.11.2019 ka parashtruar kërkesë për kompensimin e dy pagave në emër të pagave përcjellëse dhe tri pagave në emër të shpërblimit jubilar sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës. Menaxherja e Burimeve Njerëzore në Administratën



Tatimore të Kosovës, me datë 22.11.2019 i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij të datës 30.10.2019 duke e njoftuar të njëjtin se Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka humbur fuqinë ligjore sepse Oda Ekonomike e Kosovës me datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale se është tërhequr nga zbatimi i kësaj marrëveshje.

I pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit, ankuesi me datë 11.12.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shume se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njeherit nënshkruese e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e kompensimit të dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë, mbi këtë bazë ligjore, është i pa bazuar, sepse ankuesi ka arritur moshën e pensionimit me datë 07.06.2019 në kohën kur nuk ka qenë e aplikueshme Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në konstatimin si me lartë vlerëson se Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot: 324/A të datës 11.06.2019 përmes të cilit ankuesit me rastin e pensionimit ia ka njohur të drejta e kompensimit të një page përcjellëse në vlerën e pagës së fundit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenin 19 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëherëshme në vlerën e pagës së fundit.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.488/2021

Avdyll BEKTESHI

Bektashi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Jeton KOÇA

Jeton Koca
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

